

► Si mund ta shkarkoni?


Nëse keni një celular të mençur të cilësdo markë, iPhone ose Huawei, kërkoni aplikacionin në Google Play Store, ose në (këtu mund të jenë disa linqe)

<https://cutt.ly/BeSafe-iOs>

<https://cutt.ly/BeSafe-Android>

<https://cutt.ly/BeSafe-Huawei>

Zgjidhni gjuhën maqedonase, shqipe ose rome.



► Çfarë është Bëhu e sigurt?


Aplikim mobil për celularin tuaj të mençur, përmes të cilit mund të kërkoni ndihmë kur jeni viktimë e dhunës dhe ku mund të gjeni informacione për të gjitha shërbimet që ju ofrohen.

► Për kë është e destinuar?

Për të gjitha gratë, vajzat, fëmijët, secilën prej nesh e cila ndoshta edhe nuk mund të imagjojë se do të gjendet ndonjëherë në një situatë të bëhet viktimë e dhunës. Për mikeshat dhe miqtë tanë, të afërmit, për organizatat që kujdesen për viktimat.



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Punës
dhe Politikës Sociale



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Kjo broshurë është publikuar në kuadër të Projektit të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim "Fuqizimi i Këshillave Komunale" i zbatuar nga ana e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP).

► Si përdoret?

Përmes aplikacionit mundeni:

- të kërkonti ndihmë nga SOS linja për ndihmë të viktimave,
- të informoheni për organizatat që ofrojnë ndihmë,
- të njiheni me të drejtat tuaja,
- të lidheni drejtpërdrejt me ueb-faqet e organizatave për ndihmë juridike falas, për mbështetje psikosociale, për mbështetje gjatë punësimit,
- të kuptoni se ku ka strehim për viktimat,
- të jeni e dëgjuar dhe të kuptoni se cilat janë të drejtat tuaja.




► Butoni i kuq

Shtypni dhe mbajeni për 1 sekondë për të dërguar një SMS mesazh për ndihmë në SOS linjën.

► Butoni portokalli

Shtypni dhe mbajeni për 1 sekondë për t'i dërguar një mesazh një personi ose organizate që i besoni, sipas zgjedhjes tuaj. Për të dërguar një mesazh, duhet të keni kredi në telefonin tuaj dhe të futni numrin e telefonit të personit ose organizatës që i besoni.



► Mbështetja ime

Butoni portokalli i dërgon një SMS mesazh personit ose organizatës së zgjedhur. Kur klikoni në këndin e sipërm të djathtë, hapet lista e numrave të telefonit, prej nga mund të zgjidhni cilin numër do ta shënoni si një numër të besuar. Mund të zgjidhni të paktën 1 numër, kurse më së shumti 5. Duke shtypur numrin e zgjedhur mund t'i telefononi ose ta hiqni nga lista.



► Kontakte të rëndësishme

Ky ekran i përmban kontaktet më të rëndësishme të institucioneve dhe organizatave tek të cilat mund të drejtoheni. Duke shtypur numrin, aplikacioni automatikisht do të bëjë një telefonatë. Të gjithë këta numra, me përjashtim të policisë, mund të futen në fushën Mbështetja ime dhe do t'ju dërgohet një SMS mesazh.



► Të drejtat e mia

Këtu janë disa të drejta themelore me të cilat duhet të jeni të njohur.



► Këshilla

Këtu janë këshillat që mund t'i ndihmojnë çdo personi që të mbrohet nga dhuna, për veten dhe për fëmijët e vet nëse ka.



► Llojet e dhunës

Këtu mund të kuptoni se cilat lloje të dhunës ekzistojnë, sepse për ta parandaluar atë duhet të dini ta njihni atë.

► Dëshmi personale

Përmban deklarata të shkurtra personale të viktimave të dhunës.